



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 178 Datë 24.12.2012

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LIÇENSIMIT TË SHOQËRISË
“ERMA M.P” SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, gërma “a”; 9; 13 pika 1 dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4; të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “f”; 8; 10 pika 3, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, nenit 18 pika 1 gërma “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ERMA M.P” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “ERMA M.P” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b”, “c”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për liçensë të shoqërisë “ERMA M.P” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI